



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



**QENDRA E SHËRBIMEVE
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA**
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



Save the Children



R A P O R T

MONITORIMI I GJYKIMEVE ADMINISTRATIVE NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DHE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

R A P O R T

**MONITORIMI I GJYKIMEVE ADMINISTRATIVE NË
GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
DHE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT**

(JANAR - QERSHOR 2018)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Përgatiti raportin: Prof. As. Dr. Iris Petrela

“Ky raport u prodhua nga Fondacioni Qendra Europiane në kuadër të projektit “Procesi i rregullt ligjor si kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës” si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Qendra Europiane dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”

© **Qendra Europiane**

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

Qendra Europiane

Rr. “Vaso Pasha”
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri
www.euro-centre.eu

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
SHKURTIME	9
METODOLOGJIA	11
Standardet e monitorimit	11
Kohëzgjatja e monitorimit	11
Monitoruesit	11
Çështjet e monitoruara – numri, përzgjedhja, tipologjia	12
Formulari i monitorimit të seancës gjyqësore	13
Kufizime të metodologjisë	14
KAPITULLI I PARË	16
Parimet dhe veçoritë e gjykimit administrativ në Shqipëri	16
KAPITULLI I DYTË	24
Tipologjia e çështjeve të monitoruara	24
KAPITULLI I TRETË	28
Aksesi në gjykatën administrative	29
Shpallja e seancave – Kalendar i gjykimeve	30
Shpejtësia e gjykimit	31
Kohëzgjatja e gjykimit të çështjes	33
Arësyet për shtyrje të seancave gjyqësore	34
Mbrojtja me përfaqësues ligjor	36
Vendimi përfundimtar në shkallën e parë të gjykimit administrativ	40
KAPITULLI I KATËRT	42
Gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit	42
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	46

HYRJE

Raporti që po ju paraqesim është një përmbledhje dhe analizë e të dhënave të monitorimit të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, në kuadër të projektit “Procesi i rregullt ligjor si kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës”, i cili u realizua nga Fondacioni Qendra Europiane. Ky projekt po zbatohet në kuadër të skemës së granteve të projektit “Nisma qytetare për një sistem drejtësie funksional dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi në Shqipëri”, zbatuar nga Save the Children Shqipëri dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, financiar nga Bashkimi Europian.

E drejta administrative është një fushë shumë e gjerë e së drejtës, që na prek në çdo hap të jetës si anëtarë të shoqërisë dhe si pjesë e popullsisë së shtetit. Është e pashmangshme lidhja e individit, personit fizik apo juridik (privat) me hallka apo procese që rregullohen, drejtohen, kontrollohen nga normat juridike të degëve të së drejtës administrative dhe institucioneve përkatëse. Veprimtaria e organeve administrative është e gjithanshme dhe e larmishme, madje edhe dinamike. Kjo veprimtari përfshin, por pa u kufizuar, regjistrimin e qytetarëve, lëshimin e licencave ndaj personave fizikë dhe shoqërive tregtare, mbrojtjen e mjedisit, shpronësimin, apo kompensimin, planifikimin urban, funksionimin dhe bashkërendimin e kompetencave të organeve shtetërore, apo edhe qasjen në informacion. Strukturat administrative janë përballja kryesore dhe e pashmangshme e të gjitha kategorive të subjekteve të së drejtës nga njëra anë dhe shtetit, nga ana tjetër. Ky i fundit, gjatë veprimtarisë së tij konkrete me atë të institucioneve të posaçme apo personave zyrtarë mund të ndikojë pozitivisht apo negativisht liritë dhe të drejtat e subjekteve të ndryshme të së drejtës. Ndaj në një shtet demokratik, bazuar në parime e shtetit të së drejtës është

e qenësishme që kushdo që arsyeton se i është prekur, mohuar, kufizuar një e drejtë apo liri e parashikuar në legjislacion të mund të ankohet efektivisht jo vetëm në piramidën e orgave administrative, por edhe në një sistem institucionesh të pavarura, sikundër është gjyqësori administrativ. Gjykata duhet të ketë fuqinë për të shqyrtuar ligjshmërinë dhe/ ose përshtatshmërinë e akteve administrative dhe për të shpallur vendime, të cilat mund të ekzekutohen brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

Në nëntor të vitit 2013, filloi veprimtarinë e tij një sistem i ri gjykatash administrative me tre shkallë dhe me rregulla të reja të gjykimit, parashikuar në Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (LGJA). Kështu, u krijuan gjashtë gjykata administrative të shkallës së parë, në ato qytete ku kanë selinë gjykatat e apelit të juridiksionit të zakonshëm civil dhe penal. Këto gjykata janë vendosur në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Gjithashtu, është krijuar dhe funksionon prej së njëjtës periudhë edhe Gjykata Administrative e Apelit me seli në Tiranë.

Numri gjyqtarëve administrativë në gjykatat e shkallës së parë nuk është i unifikuar për të gjashta gjykatat. Kështu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka në organikën e saj 16 gjyqtarë, që nga krijimi, kurse pesë gjykatat e tjera kanë organikë të parashikuar me nga 4 gjyqtarë secila. Gjykata Administrative e Apelit fillimisht funksionoi me 7 gjyqtarë, ndërsa aktualisht ky numër është rritur në 13.

Qëllimi i ngritjes për herë të parë në Shqipëri i sistemit të gjyqësorit administrativ ishte që aktet administrative të mund të shqyrtoheshin nga gjykata të specializuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me procedura që përputhen me standarde të gjykimit të njohura e ndjekura ndërkombëtarisht në shtete ku zbatohen parimet e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Pritshmëritë e mirë funksionimit të këtij sistemi të ri, sikundër parashikohet edhe në vetë LGJA janë:

- ✓ Rritja e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë;
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së gjykimeve në lidhje me aktet administrative;

- ✓ Shmangia e vonesave në proceset që kanë të bëjnë me akte administrative;
- ✓ Ekzekutimi i përshpejtuar dhe më i efektshëm i vendimeve të gjykatës;
- ✓ Garantimi i të drejtës për gjykim të paanshëm për qytetarët.

Ky raport është i strukturuar si vijon:

- ❖ Metodologjia e zbatuar për përzgjedhjen e çështjeve për monitorim, si dhe raportimi i seancave përkatëse dhe bazën orientuese normative si arsyetim të ndjekjes së kësaj metodologjie.
- ❖ Kapitulli i Parë është një përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor vendas në lidhje me gjykimet administrative, duke theksuar parimet dhe standardet e gjykimit administrativ në Shqipëri përkundrejt të cilave analizohen të dhënat e mbledhura nga formularët e vëzhgimit të seancave gjyqësore.
- ❖ Kapitulli i Dytë paraqet një pamje të përgjithshme të llojeve të mosmarrëveshjeve administrative të hasura gjatë monitorimit.
- ❖ Kapitulli i Tretë, që përbën thelbin e raportit, prezanton dhe analizon të dhënat e grumbulluara nga vëzhguesit për çështjet e monitoruara në secilën prej gjykatave administrative të shkallës së parë përkundrejt standardeve të aksesit në gjykatat administrative, të barazisë së armëve, të drejtës për t'u mbrojtur, të drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe asaj të ankimit, duke ndjekur një këndvështrim krahasues dhe analizues për të dhënat mbi këto gjykata.
- ❖ Kapitulli i Katërt prezanton të dhëna lidhur me çështjet e apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë, analizën dhe gjetjet lidhur me këto çështje.
- ❖ Në përfundim të raportit prezantohet një përmbledhje e gjetjeve për gjykimet administrative në shkallë të parë dhe në Apel për periudhën e monitorimit janar – qershor 2018 që pasohen nga disa rekomandime se si mund të adresohen mungesat e vërejtura në gjykimet administrative në gjykatat e shkallës së parë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

SHKURTIME

Kushtetuta	Ligj nr. 8417, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, datë 21.10.1998, i ndryshuar
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e Këshillit të Evropës
KPA	Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
LGJA	Ligj nr. 49/2012, “Për organizimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
MD	Ministria e Drejtësisë
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
Dekret	Dekret i Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të Apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”

METODOLOGJIA

Standardet e monitorimit

E drejta për gjykim të paanshëm në drejtësinë administrative sipas të drejtës ndërkombëtare rrjedh nga konventa ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ).

Kohëzgjatja e monitorimit

Veprimtaria monitoruese e gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë në Shqipëri; Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe e Gjykatës Administrative të Apelit u zhvillua përgjatë një periudhe 6-mujore, nga muaji **janar deri në qershor të vitit 2018**. Për rrjedhojë, përgatitja e këtij raporti është bazuar në të dhënat e gjeneruara nga formularët e monitorimit të seancave gjyqësore.

Monitoruesit

Shtatë monitorues me formim juridik dhe me njohuri të mjaftueshme për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative në vend, u përzgjedhën nga Fondacioni Qendra Evropiane në përgjigje të një thirrje për shprehje interesi. Monitoruesit e përzgjedhur u trajnuan më gjerësisht në janar të vitit 2018 mbi kuadrin ligjor për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative në Shqipëri. Gjithashtu, ata u trajnuan në lidhje me metodologjinë e posaçme për të monitoruar seanca gjyqësore të mosmarrëveshjeve administrative dhe për të përpiluar formularin e posaçëm të monitorimit të seancës gjyqësore.

Monitoruesit, u trajnuan nga Fondacioni Qendra Europiane në lidhje me statusin e monitoruesit; qëndrimin dhe sjelljen e tyre, si dhe për qasjen ndaj gjykatës administrative dhe punonjësve të saj, për të demonstruar në çdo rrethanë respektim të solemnitetit të gjykimit administrativ dhe pjesëmarrësve në gjykim, mosndërrhyrje në proces dhe në seanca, paanësi gjatë komunikimit të mundshëm me gjykatën dhe palët pjesëmarrëse në gjykim, vëzhgim dhe raportim objektiv të aspekteve dhe etapave të ndryshme të gjykimit administrativ.

Çështjet e monitoruara – numri, përzgjedhja, tipologjia

Secili prej monitoruesve të gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë, përgjatë periudhës 6-mujore të monitorimit, ka monitoruar **32 çështje** dhe për secilën nga seancat gjyqësore (përgatitore, dëgjimore apo vendimmarrëse) ka plotësuar formularin e monitorimit. Në total janë monitoruar **192 çështje** dhe **mbi 550 seanca gjyqësore** që përbëjnë njëkohësisht kampionin e çështjeve për këtë raport. Për çështjet e monitoruara dhe të përmbyllura me një vendim përfundimtar nga gjykata administrative, monitoruesi ka marrë informacion nëse çështja është ankimuar apo jo në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky informacion i është përcjellë monitoruesit të Gjykatës Administrative të Apelit për të ndjekur më tej gjykimin dhe vendimmarrjen e mundshme pranë kësaj gjykate.

Në fillim të muajit janar, i cili përkon me fillimin e procesit të monitorimit, monitoruesit u orientuan që të përzgjidhnin në mënyrë rastësore çështjet që ishin shpallur në kalendarin e gjyqësorëve të gjykatës, nisur nga oraret e gjykatës afishuar në stendat e informacionit, ose të mbajtur në pikën e informacionit në gjykatat ku stendat mungonin. Përzgjedhja e çështjeve synoi garantimin e një shpërndarje të ekuilibruar e të shumëllojshme të tipeve të mosmarrëveshjeve administrative. Qëllimi kryesor ishte monitorimi i një larmie mosmarrëveshjesh administrative, sikundër janë ato të marrëdhënive të punës në shërbimin civil, të regjistrimit të pronës, sigurimeve shoqërore, pensionit, gjobave në lidhje me tatime, taksa apo tarifa doganore, me palë të paditur institucione shtetërore të niveleve e kompetencave të ndryshme.

Monitorimi ishte i nevojshëm për një periudhë më të gjatë për Gjykatën

Administrative të Apelit, duke pasur parasysh edhe periudhën e nevojshme të kohës që duhen për të transferuar dosjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe hedhje e shortit për caktimin e trupës gjyqësore e më tej të datës së gjykimit të çështjes së apeluar në zbatim të parashikimeve të LGJA. Pavarësisht periudhës më të gjatë, numri i çështjeve i gjykuar në shkallën e apelit gjatë periudhës së monitorimit ka qenë i ulët.

Formulari i monitorimit të seancës gjyqësore

Monitoruesit u udhëzuan për plotësimin e pyetësorit tip për vëzhgimin e seancës gjyqësore administrative. Ky pyetësor tip është prezantuar në **botimin e ODIHR Manual për Monitorimin e Drejtësisë Administrative**, të përkthyer në shqip nga OSBE, Prezenca në Shqipëri. Pyetësori tip përfshihet si shtojcë e këtij raporti.

Pyetësori përmbante këto rubrika:

- ✓ Të dhëna mbi monitoruesin, palët ndërgjyqësore dhe trupën gjyqësore;
- ✓ Të dhëna mbi mosmarrëveshjen administrative;
- ✓ Të dhëna gjinore;
- ✓ Të dhëna mbi mbrojtësin ligjor, apo përfaqësuesin ligjor;
- ✓ Të dhëna për kohën e regjistrimit të kërkesë-padisë në gjykatë dhe etapat e ecurisë së çështjes deri në marrjen e vendimit përfundimtar;
- ✓ Të dhëna mbi ndonjë vendim të ndërmjetëm të mundshëm;
- ✓ Të dhëna mbi arsyet e shtyrjeve të mundshme të seancave gjyqësore;
- ✓ Të dhëna mbi caktimin e ekspertëve për çështje të caktuara, llojin e këtyre çështjeve;
- ✓ Të dhëna mbi solemnitetin e gjykimit;
- ✓ Të dhëna mbi qëndrimet, sjelljen e pjesëmarrësve të gjykim, trupës gjyqësore dhe sekretarisë gjyqësore;
- ✓ Të dhëna mbi zhvillimin e gjykimit në mungesë apo prezencë të të dyja palëve apo njëres prej tyre;
- ✓ Të dhëna mbi mundësinë e adresimit të mosmarrëveshjes në rrugë administrative, mundësinë e shterimit të ankimit administrativ;

- ✓ Të dhëna mbi qëndrimin e gjykatës në vendimin përfundimtar mbi çështjen objekt gjykimi;
- ✓ Të dhëna mbi ankimin në apel apo jo.

Në përfundim të secilës seancë të monitoruar, vëzhguesit në gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë plotësuan pyetësonin për çështjet që vëzhguan. Pas marrjes së pyetësonit të plotësuar, stafi i projektit i komunikoi informacionin e nevojshëm, për çështjet e apeluara, vëzhguesit gjyqësor që punonte në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky informacion përfshinte numrin e çështjes, numrin e vendimit dhe datën kur ishte regjistruar ankimi në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Vëzhguesi për Gjykatën Administrative të Apelit më pas ka kërkuar hollësi nga zyra e informacionit/tabela e shpalljes së shortit, trupave gjyqësore dhe datave të gjykimeve në Gjykatën Administrative të Apelit, në mënyrë që vëzhguesi të merrte informacionin e nevojshëm në lidhje me qëndrimin dhe vendimin e kësaj gjykate për ankimin e paraqitur.

Kufizime të metodologjisë

Monitorimi i gjykimeve administrative ka pasur disa kufizime metodologjike dhe kjo është e zakonshme për çfarëdo angazhimi në formë monitoruese. Për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare monitorimi i gjykatave administrative **është përqendruar në një kohë të kufizuar dhe në një numër të kufizuar çështjesh të monitoruara**, të përcaktuara në projekt si numër kampion çështjesh.

Së pari, monitorimi është përqendruar kryesisht në monitorim të seancave gjyqësore. Pra, në mbajtjen e të dhënave dhe informacionit që lidhen me çfarë ndodh në seancë gjyqësore, sipas llojeve të ndryshme të seancave gjyqësore; paraprake, dëgjimore, vendimmarrëse, për lëshim urdhër ekzekutimi (sipas një rendi kohor). Përsa i takon plotësimin të kuadrit të informacionit mbi çështjen janë marrë edhe vendimet e zbardhura për çështjet e zgjidhura me vendim përfundimtar nga gjykatat administrative gjatë periudhës së monitorimit.

Së dyti, periudha e monitorimit përbën një nga kufizimet metodologjike të kësaj veprimtarie. Kjo periudhë ka qene gjashtë mujore, nga janari deri në qershor 2018. Për marrjen e vendimeve përfundimtare nga gjykatat e

shkallës së parë periudha e angazhimit të monitoruesve është shtrirë edhe gjatë muajit korrik 2018.

Së treti, një kufizim tjetër i vendosur që në fillim të veprimtarisë monitoruese është raportimi (fotografimi me besnikëri) i ecurisë së seancave gjyqësore, kërkesave dhe prapësimeve të palëve dhe vendimeve përkatëse të gjykatave administrative. Monitorimi i gjykimeve administrative nuk ka patur si qëllim të hyjë në themel të vendimmarrjes nga ana e gjykatave dhe të paraqesë konsiderata apo analiza lidhur me vendimmarrjen e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të apelit.

Së katërti, monitorimi i seancave të gjykimeve administrative është shtrirë në dy shkallë; shkallën e parë dhe të apelit dhe nuk ka përfshirë gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë, Kolegjin Administrativ dhe as nuk është zgjeruar në monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. Këto kufizime janë rrjedhoja të drejtpërdrejta të periudhës së përcaktuar për monitorimin e gjykimeve administrative, e cila bazohet edhe nga afatet treguese apo edhe për afërsisht të përlllogaritshme për kohëzgjatjen e gjykimeve administrative, sikundër paraqiten në vetë LGJA, nga çasti i regjistrimit të kërkesë-padisë në gjykatën administrative në shkallën e parë derisa të zgjidhet çështja në themel, parashikimit të mundësisë së apelit dhe përcjelljes së dosjes në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë dhe kohëzgjatjen e gjykimit administrativ në apel.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, një kujdes i posaçëm, sidomos në përgatitjen e raportit përmbledhës së monitorimit i është kushtuar respektimit të të dhënave personale të palëve pjesëmarrëse në gjykimet/seancat e monitoruara.

KAPITULLI I PARË

Parimet dhe veçoritë e gjykimit administrativ në Shqipëri

Parimet në të cilat bazohet gjykimi administrativ janë të parashikuara në LGJA¹, si vijon:

1. Gjkata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një **procesit të rregullt gjyqësor** dhe **brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues edhe ligjore të subjekteve**, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike.
2. Gjkata administrative zbaton **parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë**.
3. Organi i administratës publike, si rregull, **ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve** të kryera prej tij.
4. Gjkata administrative, sipas natyrës së çështjes, **shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi. Mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit**.

Me anë të pyetësorit të monitorimit janë grumbulluar të dhëna në lidhje me periudhën kohore që nga regjistrimi i kërkesë-padisë në gjykatën përkatëse të shkallës së parë deri në kohën e dhënies së vendimit përfundimtar nga

kjo gjykatë. Gjithashtu, të dhënat lidhur me ushtrimin e të drejtës për të patur mbrojtje të kualifikuar ligjore për subjektet private dhe përfaqësim ligjor të autorizuar për subjektet shtetërore. Në ndihmë të shpejtësisë së gjykimit janë edhe parashikimet për gjykim edhe mbi bazë aktesh shkresore dhe në mungesë apo mosparaqitje të palëve. Këto janë parashikime të rëndësishme për të shmangur shtyrjen e seancave gjyqësore.

Në lidhje me barazinë e palëve gjykata administrative kujdeset të ruajë ekuilibrin midis interesit publik dhe të drejtave dhe interesave të ligjshëm të personave privatë. Megjithatë, në gjykimet administrative parashikohet që barra e provës t'i kalojë organit shtetëror.

Gjkata administrative ka kompetencë lëndore² në lidhje me mosmarrëveshjet që lindin:

1. nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
2. për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
3. nga mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;
4. nga mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organi i administratës publike;
5. nga kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
6. nga kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

¹ Neni 3, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ndryshuar.

² Neni 7, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ndryshuar.

Gjithashtu, LGJA përveçse parashikon tipet e mosmarrëveshjeve të cilat përfshihen në kompetencën e vet lëndore, parashikon qartë edhe rastet e mosmarrëveshjeve që nuk mund të gjykohen nga gjykata administrative:

1. kur mosmarrëveshja lidhet me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
2. kur mosmarrëveshja sipas legjislacionit në fuqi është në kompetencën e një gjykate tjetër.³

Pavarësisht këtyre parashikimeve dhe një periudhe rreth 5-vjeçare të funksionimit të gjykatave administrative, nga monitorimi në gjykatat administrative të shkallës së parë ka ende kërkesë padi që nuk përfshihen në rastet e kompetencës lëndore të këtyre gjykatave. Kjo dëshmon për njohje jo të plotë e të saktë të ligjit të posaçëm mbi gjykimet administrative nga ana e subjekteve private që kanë vënë në lëvizje gjykatën administrative. Përsa i takon mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet e punës, ndryshimi ligjor në kompetencën lëndore të gjykatave administrative rezulton se nuk njihet gjerësisht. Kështu, LGJA ka pësuar ndryshim, kufizim të kompetencës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të punës, duke u dhënë kompetencë gjykatave administrative të zgjidhin mosmarrëveshjet e punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përfshihen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.⁴

Në mënyrë që të vihet në lëvizje gjykata administrative me anë të një padie administrative është kusht i domosdoshëm ligjor shterimi i ankimit administrative.⁵ Megjithatë, nga ky rregull i përgjithshëm ka edhe disa përjashtime të parashikuara shprehimisht në LGJA. Kështu, kushdo që ka ankesë të natyrës administrative mund t'i drejtohet gjykatës administrative

kur ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është krijuar. Një rast tjetër përjashtimor është kur ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë. Rasti i fundit është kur organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.⁶

Ekzistojnë disa afate kohore, të cilat duhet të respektohen për të vënë në lëvizje gjykatën administrative dhe kjo e fundit të pranojë të marrë në shqyrtim për zgjidhje në themel të padisë. Më konkretisht, padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve.⁷

Koha kur fillon ky afat është e ndryshme për rrethana të ndryshme të parashikuara qartë në LGJA, sikundër janë:

- a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;
- b) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;
- c) data e botimit të aktit administrativ, në rastet kur ligji parashikon detyrimin për botimin e aktit;
- ç) data e marrjes së dijenisë për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit, me çdo lloj veprimi që nuk plotëson kushtet dhe formën e aktit administrativ;
- d) data e mbarimit të afatit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit administrativ, kur akti administrativ që është kërkuar të nxirret ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;
- dh) data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë

³ Neni 8, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ndryshuar me ligjin nr.100/2014, datë 31.07.2014 dhe ligjin nr.100/2017, datë 30.03.2017.

⁴ Ndryshimi i nenit 7, shkronja "ç" e LGJA

⁵ Neni 16, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ndryshuar me ligjin nr.100/2014, datë 31.07.2014 dhe ligjin nr.100/2017, datë 30.03.2017.

⁶ Shih shënimin në fund të faqes nr.5

⁷ Neni 18, pika 1, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ndryshuar.

administrativ.

Gjithashtu, në raste kur nuk ka parashikime të sakta për të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë në vetë aktin administrative ky afat është 1 vit.⁸

Mundësia e fundit që ofron LGJA është që në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.

Në lidhje me një akt nënligjor normativ, padia kundër këtij akti duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Rasti i fundit nuk ka qenë objekt i monitorimit të gjykatave administrative në kuadër të projektit të Fondacionit Qendra Europiane, por vetëm rastet e mosmarrëveshjeve administrative që rrjedhin prej akteve administrative, apo mosnxjerrjes së akteve administrative nga organet shtetërore.

Duke qenë se fusha e të drejtës administrative është tepër e gjerë, legjislacioni i nëndegëve të saj parashikon afate të ndryshme të ngritjes së padisë përkatëse. Më konkretisht, paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm, kurse paditë për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Rastin e padisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative LGJA e ka parashikuar që padia të paraqitet brenda 6 muajve nga lindja e mosmarrëveshjes pranë gjykatës administrative. Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.⁹

⁸ Neni 18, pika 2, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar.

⁹ Neni 18, pika 7, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar.

Vetëm për rastin kur padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nuk ka asnjë kufizim kohor se kur mund të ngrihet padia pranë gjykatës administrative, pra, një padi e tillë mund të ngrihet në çdo kohë.

Sikundër edhe në gjykime të natyrave të tjera, vendimi përfundimtar që merr gjykata administrative¹⁰ duhet të përmbajë disa elemente të domosdoshme si vijon:

- a) *përcaktimin e qartë të çështjeve, në pjesën arsyetuese...*
- b) *përcaktimin në pjesën urdhëruese, se kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.*

Po kështu, shpallja dhe depozitimi i vendimit i nënshtrohet disa rregullave të qarta si vijon:

1. *Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar.*
2. *Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.*
3. *Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.¹¹*

Pavarësisht se parashikimi i përgjithshëm ligjor është e drejta e ankimit në një gjykatë të një shkalle më të lartë për këdo që nuk pajtohet me vendimin e një gjykate të një shkalle më të ulët, LGJA i ka të parashikuara shprehimisht disa raste kur nuk lejohet ankim gjyqësor dhe vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë nga përfundimtar kthehet në të formës së prerë. Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

¹⁰ Neni 41, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar.

¹¹ Neni 42, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar.

- a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.¹²

Për të gjitha rastet e tjera që lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.¹³ Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi. Gjykata Administrative e Apelit dërgon dosjen në gjykatën administrative të shkallës së parë jo më vonë se 3 ditë pas kryerjes së njoftimit të vendimit të palëve.

Ndryshe nga parashikimi për gjykimin administrativ në shkallën e parë si rregull me dyer të hapura, shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit¹⁴,

¹² Neni 45, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar me ligjin nr.100/2014, datë 31.07.2014 dhe ligjin nr.100/2017, datë 30.03.2017.

¹³ Neni 48, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar me ligjin nr.100/2014, datë 31.07.2014 dhe ligjin nr.100/2017, datë 30.03.2017.

¹⁴ Neni 49, Ligji nr. 49/2012, datë 3.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave

për të përshpejtuar procesin, kur kjo gjykatë çmon se dosja është e plotë dhe nuk nevojitet thirrja dhe paraqitja e palëve ndërgjygjëse. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.







administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ndryshuar me ligjin nr.100/2014, datë 31.07.2014 dhe ligjin nr.100/2017, datë 30.03.2017.

KAPITULLI I DYTË

Tipologjia e çështjeve të monitoruara

Çështjet e monitoruara janë të **tipologjive të ndryshme**, ma dje është e mundur të vërehet edhe prirja nga gjykata në gjykatë. Për shembull, në gjykatat bregdetare apo afër kufirit tokësor me shtete të tjera ka shumë çështje në lidhje me detyrimet/tarifat doganore. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër vihen re një sërë çështjesh ku ankuesit (qytetarët) kërkojnë korrigjimin e të dhënave të regjistrave të gjendjes civile.

Tipologjia e çështjeve të monitoruara sipas gjykatave të shkallës së parë



Përsa i takon marrëdhënieve të punës, sikundër është parashtruar edhe në Kapitullin e Parë, LGJA ka pësuar ndryshim, kufizim në kompetencën lëndore të trajtimit të mosmarrëveshjeve për marrëdhënie pune vetëm në fushën e shërbimit civil, pra, kur punëmarrësi gëzon status apo është angazhuar në procedura që rezultojnë në status të posaçëm për punëmarrësin. Për rrjedhojë, kjo ka sjellë një numër të ulët të çështjeve për marrëdhënie pune në tërësinë e gjykimeve administrative. Në Gjykatën Administrative Tiranë, në terma relativë, është vëzhguar numri më i lartë i mosmarrëveshjeve në fushën e marrëdhënieve të punës të shërbimit civil. Ndërkohë, në

të gjashta gjykatat e shkallës së parë administrative ka një numër të konsiderueshëm mosmarrëveshjesh administrative në fushën e lejeve të tipeve të ndryshme, licensave, gjobave tatimore dhe detyrimeve doganore. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, nga 32 çështje të monitoruara 26,32% u përkasin mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me pensionet, pra, mbi ¼ e çështjeve të monitoruara janë mosmarrëveshje me institucionin e sigurimeve shoqërore. Në rastin e monitorimeve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Shkodër, vërehen një numër i lartë rastesh kur pala e interesuar vë në lëvizje gjykatën për të nxjerrë urdhër ekzekutimi kur vendimi përkatës ka marrë formë të prerë. Kështu, nga monitorimi në Durrës rreth 42% e rasteve të monitoruara kanë qenë seanca për udhëra ekzekutimi dhe në rastin e Shkodrës kjo përqindje është 30% e 32 çështjeve të monitoruara në total. Në këto raste mund të konkludojmë se nga zgjidhja e çështjeve në themel dhe marrja e formës së prerë të vendimit kalon kohë, së cilës i shtohet edhe koha për vënien në lëvizje përsëri të gjykatës administrative që të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Pavarësisht, se monitorimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore administrative nuk është në fokusin dhe metodologjinë e këtij projekti monitorimi, nga pikëpamja e elementit kohë, i cili është i përfshirë në monitorim, mund të themi se nuk ndikon pozitivisht në shkurtimin e afatit kohor në tërësi për një çështje administrative. Një ndër synimet për krijimin e sistemit gjyqësor administrativ në Shqipëri ishte gjykimi i efektshëm në një periudhë kohe të arsyeshme, më të shkurtër se në gjykime pranë seksioneve administrative të gjykatave të shkallëve të para civile në vend.

Në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe informacionin e pasqyruar në formularët e monitorimit të gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë, përveç çështjeve tipike administrative janë raportuar edhe një grupim çështjesh nën klasifikimin e tipologjisë si 'të tjera'. Kjo e dhënë si përqindje varion nga 3% deri 12.5%. Duke patur parasysh se për secilën gjykatë të shkallës së parë janë monitoruar 30-32 çështje, mund të themi se çështjet e klasifikuara si 'të tjera' janë nga 1, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Shkodër deri maksimumi në 3 të tilla në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në periudhën 6-mujore të monitorimit. Bazuar në shpjegimet e monitoruesve këto kanë qenë çështje të lëndës civile, pra, janë konstatuar nga gjykata administrative si jashtë

kompentencës së tyre lëndore dhe aktet i janë kthyer palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Pavarësisht se gjykatat administrative janë në funksionim prej nëntorit të vitit 2013, ka ende mungesë njohurish nga ana e qytetarëve se cilës gjykatë duhet t'i drejtohen për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre – asaj civile apo administrative. Në të gjitha rastet e mësipërme, 11 në total në të gjashta gjykatat administrative të shkallës së parë, pala ankuese kanë qenë individë, në disa raste të përfaqësuar ligjërisht edhe me avokat.

KAPITULLI I TRETË

Ky kapitull fokusohet në çështjet e aksesit në gjykata, kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve, rastet e shtyrjeve të seancave dhe arsyet e këtyre shtyrjeve - përkundrejt parimeve të gjykimit pa vonesa dhe efektivitetit, mundësinë e përdorimit të mbrojtjes me përfaqësues ligjor - për të realizuar parimin e barazisë së armëve. Të dhënat e nxjerra nga formularët e monitorimit paraqiten në formën e grafikëve, shoqëruar me interpretim krahasues midis gjykatave administrative të shkallës së parë, si edhe me analizën përkatëse. Secila çështje përmban gjithashtu edhe sugjerime për ndrejtje të situatave të ngjashme në të ardhmen. Në përgjithësi, të gjithë vëzhguesit e gjykatave raportuan se **gjykatat administrative kanë ngarkesë pune të konsiderueshme**, çka bën që gjyqtarët të kenë seanca gjatë gjithë orarit zyrtar. Gjithashtu, të gjithë vëzhguesit raportuan se **monitorimi i tyre është pranuar** në përgjithësi nga kryetarët, gjyqtarët, kancelarët dhe stafi i gjykatave dhe nuk janë hasur raste të refuzimit të monitorimit nga palët ndërgjygjëse.

Nga formularët e monitorimit është bërë e mundur të identifikohen aspekte të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore pranë secilës gjykatë administrative, si dhe qëndrimi dhe sjellja e palëve konkrete, personelit të gjykatave dhe gjyqtarëve ndaj monitoruesve.

Nga pikëpamja e mjediseve, infrastrukturës së gjykatës, si dhe personelit gjyqësor, vërehen përmirësime në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka ndryshuar vendodhjen e saj dhe ka hapësira më të përshtatshme sesa vendodhja e mëparshme, si dhe është në funksionon me organikë të shtuar nga 7 gjyqtarë në vitin 2013 në 13 aktualisht.

Nga formularët e monitorimit vihet re se gjykatat kujdesen të kontrollojnë afatet e ankimit/ regjistrimit të kërkesë-padisë në gjykatën administrative dhe dorëzimit të provave shkresore, për të kaluar më pas në një vendimmarrje.

Aksesi në gjykatën administrative

Si në të drejtën ndërkombëtare, ashtu edhe në legjislacionin vendas, **aksesi në gjykatë** konsiderohet një element tepër i rëndësishëm për vetë vijueshmërinë dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në shoqëri. GJEDNJ vlerëson se aksesit në gjykatë është pjesë e pandashme e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuadër të nenit 6 të KEDNJ. Seanca duhet të zhvillohet në një vend që i'u mundëson palëve pjesëmarrje efektive në gjyq.

E drejta e palëve për akses efektiv në gjykata mund të shkelet, nëse informacioni për orarin dhe vendin e seancës është i pamjaftueshëm. E drejta e aksesit kërkon edhe që shteti të marrë masa të arsyeshme për të vënë në dispozicion dokumentet dhe vendimet për palët ndërgjygjëse. Palët në një çështje dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë duhet të kenë akses në të gjithë informacionin e nevojshëm, përfshirë provat dhe dokumentet e tjera që mund t'i ndihmojnë për të përgatitur plotësisht çështjen, ose që të çlirohen nga përgjegjësia. Ky akses duhet dhënë brenda një kohe sa më të shkurtër dhe të përshtatshme.

Vendodhjet e gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë nuk kanë ndryshuar që në themelimin e tyre dhe nga pikëpamja e aksesit fizik në to ka ende probleme për personat me aftësi të kufizuara. Pavarësisht se LGJA nuk kërkon domosdoshmërisht pjesëmarrjen e palëve në gjykim, madje gjykimi mund të vijojë edhe pa prezencën e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën bazuar vetëm në dokumentacionin e dorëzuar në gjykatë, standardet e aksesit fizik në mjediset e gjykatave administrative duhen të sigurohen për këdo.

Sikurse e përmendëm më lart, vendodhja e gjykatave administrative të shkallës së parë nuk ka ndryshuar, që nga themelimi i tyre. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ndodhet në një godinë 4-katëshe të rinovuar, larg Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Godina nuk ka ashensor.

Dy hyrjet ndahen nga një rrethim dhe mure, ku njëri është për publikun (palët) dhe tjetra për gjyqtarët dhe punonjësit e tjerë të gjykatës. Çdo gjyqtar ka zyrën e vet ku rri edhe sekretaria gjyqësore e caktuar. **Gjykata nuk është fizikisht e aksesueshme** nga personat paraplegjik. Rampa në hyrje të godinës mundëson hyrjen deri tek salla e pritjes. Salla e pritjes është e ndarë me disa shkallë nga pjesa tjetër ku shpallen sallat e seancave gjyqësore. Të gjitha sallat e gjyqit ndodhen të shpërndara nëpër katet e gjykatës dhe një prej tyre ndodhet në katin përdhës të kësaj gjykate. Gjykatat e tjera të shkallës së parë kanë **pengesa** të ngjashme **për aksesin fizik** në mjediset e gjykatës. Hyrja në gjykatat administrative të shkallës së parë në **Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë** është vetëm me shkallë - **nuk ka ashensorë apo rampa**. Gjendja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë **Korçë** është më e mirë, pasi mjediset e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë janë në **katin përdhës** dhe e vetmja sallë gjyqi ndodhet afër hyrjes kryesore, po në këtë kat. Kjo sallë gjyqi ka hapësirë të bollshme dhe mund të akomodojë personat me nevoja të veçanta. Megjithatë, kjo gjykatë ka **vetëm një sallë gjykimi**, sikundër edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, apo Shkodër fakt ky, që ndikon për planifikimin e koordinuar të orareve të seancave ndërmjet gjyqtarëve përkatës që të mos krijojnë përplasje orari apo vonesa duke penguar kolegën, që të zhvillojë seancën e planifikuar.

Gjatë procesit të monitorimit të gjyqeve, të gjithë vëzhguesit raportuan se **komunikimi** i tyre me zyrat e informacionit, sekretaritet dhe kryetarët e gjykatave përkatëse ka qenë **konstruktiv**.

Shpallja e seancave – Kalendari i gjykimeve

Gjykatat administrative përdorin tabela informuese brenda hyrjes kryesore të gjykatës. Gjithashtu, funksionon edhe faqja e internetit www.gjykata.gov.al ku pasqyrohet një informacion i tërësishëm mbi numrin e çështjes, datën e regjistrimit në gjykatën administrative, shortin për gjyqtarin, palët, objektin e mosmarrëveshjes administrative, bazën ligjore, seancat e planifikuara, sallën për seancën, vendimin e gjykatës me numrin dhe datën përkatëse. Megjithatë, **informacioni për secilën kategori të përmendur më lart jo gjithnjë pasqyrohet në kohë reale në portal.**

Përsa i takon njoftimeve të seancave javore, në secilën nga gjykatat administrative të shkallës së parë mungon **një model i njehsuar për listat e seancave**: disa lista fillojnë me orarin e seancës, të tjerat me numrin e çështjes, e disa të tjera me emrin e paditësit. Informacioni që përmban lista ndryshon sipas gjyqtarit: disa lista kanë numrin e çështjes, llojin e seancës (përgatitore, gjykim, dhënie vendimi, etj.), ose objektin e çështjes, ndërsa të tjerat nuk e kanë.

Duhet theksuar se të gjithë vëzhguesit rregullisht raportuan se arritën të merrnin kalendarin e gjykatës çdo javë, përgjatë gjashtë muajve të monitorimit pa hasur asnjë vështirësi. Gjithashtu, në përfundim të monitorimit të seancave gjyqësore, **gjyqtarët dhe personeli i gjykatave** kanë qenë **mjaft bashkëpunues** në dhënien e informacionit mbi vendimet gjyqësore përfundimtare të zbardhura, si dhe për regjistrimet e apelimeve të mundshme. Ky informacion është marrë deri në dhjetë ditëshin e parë të muajit korrik. Përtej kësaj date, ankimet e mundshme janë raportuar “pa informacion” në formularët e monitorimit për çështjet e vëzhguara gjatë muajit qershor 2018.


Shpejtësia e gjykimit

Për tregues të shpejtësisë së gjykimit u jemi referuar të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e monitorimit në lidhje me **numrin e seancave** për çështjet e monitoruara (nga 32 për secilën gjykatë administrative të shkallës së parë), **arsyeve të shtyrjes** së gjykimit, si dhe **kohëzgjatjen** e çështjes nga regjistrimi deri në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë përkatëse.

Në grafikët në vijim paraqitet për secilën gjykatë administrative të shkallës së parë **përqindja** e numrit të seancave për çështjet e zgjidhura me një vendim përfundimtar nga gjykata përkatëse. Sikundër vihet re mbizotërojnë numri 1 apo 2 i seancave për shumicën e gjykatave administrative, që dëshmon se shumica e çështjeve zgjidhen me 2 seanca – rasti i Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë **Durrës me 58%, Korçë me 52,6%** dhe **Tiranë me 50%**, apo 1 seancë gjyqësore – rasti i Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë **Gjirokastrë me 59,4%** të të gjitha seancave të monitoruara dhe **Shkodër me 56,3%**. Duhet theksuar se në këtë numër seancash **nuk përllogaritet seanca përgatitore**, por numërimi ka filluar nga seanca e parë dëgjimore. Vetëm

në rastin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë **Vlorë** vërehet se mbizotëron numri 3 i seancave gjyqësore për plot 50% të numrit të seancave të monitoruara.


Nisur nga këto të dhëna statistikore mund të nxjerrim si përfundim se **gjykatat administrative të shkallës së parë realizojnë gjykime brenda afateve të arsyeshme dhe për çështjet e monitoruara, 192 në total nuk ka patur asnjë rast që numri i seancave të nevojshme për të zgjidhur me vendim përfundimtar një çështje në shkallë të parë të kalojë numrin 4 të seancave.**







Kohëzgjatja e gjykimit të çështjes

Treguesi tjetër për gjykimin efektiv dhe pa vonesa i përdorur për monitorimin e gjykimeve administrative është **kohëzgjatja totale në muaj** e çështjeve administrative nga çasti i regjistrimit pranë gjykatës administrative përkatëse të shkallës së parë deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar nga gjykata, duke e rrumbullakosur këtë datë me datën e fundit të muajit përkatës.

Grafikët në vijim paraqesin një tablo të plotë të kohëzgjatjes në muaj të çështjeve të monitoruara nga janari deri në qershor 2018. Sikurse shihet, **mbizotëron përqindja e çështjeve të zgjidhura për një muaj nga kalimi në seancë gjyqësore të çështjes.** Duke e lidhur me paraqitjen grafike të numrit të seancave për çështje, shumica e çështjeve zgjidhen nga gjykatat e shkallës së parë brenda një muaji, gjë që tregon se gjykatat caktojnë më shumë sesa një seancë brenda të njëjtit muaj me qëllim ecurinë pa vonesa të gjykimit. Vetëm në rastin e **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë mbizotëron më përqindje zgjidhja e çështjeve brenda 2 muajve me 44%** të 32 çështjeve të monitoruara në këtë gjykatë, kurse për të gjitha gjykatat e tjera të shkallës së parë mbizotërojnë çështjet që zgjidhen brenda një muaji – në **Durrës kjo shifër përkon me 65.6%** të çështjeve të monitoruara, në **Gjirokastrë me 71%**, në **Korçë me 43%**, në **Shkodër me 75%**, si dhe në **Tiranë 59,4 %** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Përqindja e çështjeve të zgjidhura me vendim përfundimtar përtej 3 muajve është e ulët në secilën nga këto gjykata.










Arsyet për shtyrje të seancave gjyqësore

Në tabelat në vijim janë pasqyruar të dhënat e formularëve të monitorimit për arsyet e mundshme të shtyrjes së seancave gjyqësore duke listuar si të tilla: kërkesën para trupit gjykues të palëse paditëse, kërkesën e palës së paditur, domosdoshmërinë për caktim eksperti e dalë në pah gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore të çështjes, kërkesë nga eksperti për më tepër kohë në përgatitjen e raportit të ekspertimit, pjesëmarrjen e gjyqtarit/es në trajnim vazhdues, mungesën e gjyqtarit/es për arsye shëndetësore. Në të dhënat e grumbulluara për të gjitha gjykatat e shkallës së parë shihet **mbizotëruese si arsye për shtyrje seance kërkesa nga pala e paditur** në përqindje të lartë. Për secilën nga gjykatat kjo **luhatet nga 55.6% në rastin e Vlorës deri në 66.7% në rastin e Gjirokastrës dhe Shkodrës**, kurse **gjykatat e tjera janë midis këtij segmenti**. Si arsye të tjera janë kërkesat nga pala paditëse ose caktimi i ekspertit dhe lënie kohë deri në seancën pasardhëse për përgatitjen

e aktit të ekspertimit përkatës. Në rastin e monitorimeve në Vlorë dhe Tiranë **44.4% dhe 40% janë rastet e shtyrjeve të seancave për caktim eksperti**. Për monitorimin e zhvilluar në Durrës, si arsye e renditur e dyta në këtë gjykatë për shtyrje seance janë **kërkesa e palës paditëse me 25% të rasteve**. Nga vëzhgimi përmbledhës për të gjitha gjykatat e shkallës së parë duket qartë se pala e paditur është ajo që shkakton zvarritje të procesit gjyqësor. Duke i'u referuar informacionit në formularët e monitorimit pala e paditur në të gjitha këto raste ka qenë një institucion shtetëror, qendror apo vendor.






Mbrojtja me përfaqësues ligjor


Në lidhje me mundësinë e palës jo institucion shtetëror, pra individ apo shoqëri tregtare për t'u mbrojtur në gjykimin administrativ me avokat, në formularin e monitorimit për secilën seancë të monitorimit është plotësuar seksioni përkatës duke ofruar tre mundësi: pala jo shtet është përfaqësuar me avokat, nuk është përfaqësuar me avokat, ose është përfaqësuar me avokat por jo në të gjitha seancat, kur gjykimi i çështjes administrative përkatëse është zhvilluar në më tepër sesa një seancë (këtu kemi parasysh rastet e prezantuara të seksionit më lart në këtë kapitull lidhur me numrin e seancave të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me vendim përfundimtar nga gjykata administrative e shkallës së parë).

Në grafikët në vijim pasqyrohen të dhënat e formularëve të monitorimit për secilën gjykatë të shkallës së parë. Kështu, për çështjet e monitoruara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nuk janë vërejtur seanca ku përfaqësuesi ligjor i palës individ apo shoqëri tregtare të mos ketë qenë prezent. Në rastet e monitorimit në gjykatat e tjera, **përfaqësimi i palës me avokat është në përqindje tepër të lartë - nga 80,65% deri në gati 91%** të seancave të monitoruara. Kanë qenë të pakta seancat kur pala jo institucion shtetëror nuk është përfaqësuar me avokat, duke zgjedhur kështu të mbrohet vetë. Kjo përqindje është nga 3% në rastin e monitorimeve në Gjirokastrë deri në 19,3% në rastin e monitorimeve në Shkodër. Në këtë

të fundit është vërejtur edhe rasti kur pala jo institucion shtetëror ka qenë e përfaqësuar me avokat, por ky i fundit nuk është paraqitur në të gjitha seancat e planifikuara për atë çështje. Kjo përqindje seancash të monitoruara në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër është 19,35%.



Në vijim paraqiten të dhënat në lidhje me mbrojtjen me përfaqësues ligjor të autorizuar të institucionit shtetëror në gjykimet administrative. Pyetja në formularin e monitorimit është ndërtuar në të njëjtën mënyrë si në rastin e mundësisë së mbrojtjes me përfaqësues ligjor të palës jo institucion shtetëror për të bërë të mundur krahasimin e të dhënave nga monitorimi.



Sikundër shihet nga grafikët e mësipërm, institucionet shtetërore, goftë qendrore apo vendore, në ndryshim nga pala jo shtet, në gjykimet administrative, kanë një përqindje përfaqësimi më të ulët. **Institucionet shtetërore tregohen më indiferente** ndaj **pjesëmarrjes në gjykimet administrative** duke i'u referuar më tepër mundësisë së vijimit të procesit gjyqësor pa praninë e palëve dhe zhvillimi i seancës gjyqësore edhe vetëm mbi bazë aktesh, mundësi që e njuh dhe LGJA.







Në rastin e Gjykatës Administrative Gjirokastrë, mungesa e përfaqësuesit ligjor të autorizuar nga institucioni shtetëror është më e larta, 75%. Nëse i'u referohemi të dhënave të numrit të seancave, kjo gjykatë kishte numrin më të lartë të përfundimit të çështjeve me një seancë gjyqësore. Duke patur zhvillimin e seancave gjyqësore me një nga palët ndërgjyqëse kjo gjykatë i ka përfunduar gjykimet duke u bazuar në seancën përgatitore dhe seancën dëgjimore, ku është paraqitur kryesisht pala ankuese, ajo që ka vënë në lëvizje gjykatën. Kështu që, gjykimi është zhvilluar shpejt dhe gjykata ka shpallur pa vonesa vendimin përfundimtar mbi bazë të akteve të paraqitura dhe shpjegimeve të vetëm njëres prej palëve, asaj ankuese. Përsëri, në rastin e kësaj gjykate ka patur edhe çështje kur përfaqësuesi i institucionit ndonëse është paraqitur në një seancë nuk ka vijuar të përfaqësojë institucionin shtetëror në seancat në vijim, për çështjet që kanë vijuar me më shumë sesa një seancë gjyqësore në 3% të seancave të monitoruara.

Në rastin e monitorimeve në Shkodër përqindja e seancave ku përfaqësuesit e autorizuar të institucioneve shtetërore kanë qenë prezent me rastet kur nuk kanë qenë prezent është e njëjtë 43,75%. Ka pasur 12,5% të seancave të monitoruara ku përfaqësuesi i institucionit shtetëror nuk është paraqitur në çdo seancë të çështjes përkatëse. Gjithsesi të dhënat për përfaqësim me mbrojtës ligjor për institucionet shtetërore mbeten të ulta në krahasim me përfaqësimin me mbrojtës ligjor të palës jo shtet për të gjitha gjykatat administrative të shkallës së parë, duke treguar prirjen për më shumë indiferentizëm nga institucionet shtetërore në krahasim me individët apo shoqëritë tregtare ndaj mosmarrëveshjeve administrative, që ju paraqiten për zgjidhje gjykatave administrative. Kështu, përfaqësimi ligjor i institucioneve shtetërore në gjykimet administrative varion nga 22% të seancave të monitoruara në Gjirokastrës deri në 65.6% në Vlorë, që është

një segment i dukshëm më i ulët përfaqësimi ligjor nga ai i individëve dhe i shoqërive tregtare, që varion nga 80.65% në Shkodër deri në 100% në Durrës për të gjitha çështjet e monitoruara.

Vendimi përfundimtar në shkallën e parë të gjyimit administrativ

Vendimmarrja e gjykatave të shkallës së parë pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm. Informacioni i mbledhur është organizuar në 4 kategori: pranim i plotë i kërkesë padisë, rrëzim i kërkesë padisë, pranim i pjesshëm dhe pezullim i gjyimit deri në plotësimin e kushtit të pezullimit. Sikundër është sqaruar në kufizimet e metodologjisë së monitorimit, ndër synimet e monitorimit nuk ka qenë analizimi i thelbimit të vendimmarrjes së gjykatave administrative, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit. Për synimet statistikore paraqesim të dhënat sipas secilës kategori vendimi ku vërehet se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka dhënë më shumë vendime në favor të palës ankuese, në 71.88% të çështjeve të monitoruara e ndjekur nga Gjykata Administrative Gjirokastrë për 68.75% të çështjeve, kurse për çështjet e monitoruara në Tiranë gjykata përkatëse ka dhënë vendime kundër palës ankuese për 65.63% të çështjeve të monitoruara duke vendosur në favor në palës ankuese për vetëm 18.75% të çështjeve (6 çështje) e ndjekur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me 50% të vendimeve (16 çështje). Gjithashtu, vërehen raste të dhënies së vendimeve të pranimit të pjesshëm të kërkesë padive, ndërsa përqindja e këtyre rasteve është e ulët në përgjithësi në të gjitha gjykatat, ku shifrën më të lartë e ka Korça me 18.75% (pra, 6 nga 32 çështje të monitoruara gjithsej në këtë gjykatë).



KAPITULLI I KATËRT

Gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit

Secili nga monitoruesit e gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë, në përfundim të monitorimit të çështjeve, ka marrë informacion edhe përsa i takon ankimit të vendimit përfundimtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e dhënë është pjesë e informacionit të kërkuar në formularin e monitorimit, pjesë, që është jashtë monitorimit të seancave gjyqësore. Të gjithë monitoruesit raportojnë se personeli ndihmës i gjykatave ju ka ofruar informacionin e nevojshëm nëse vendimi përfundimtar përkatës mbi çështjen e monitoruar është ankimuar apo jo në Gjykatën Administrative të Apelit.

Informacioni i grumbulluar përmes pyetësorëve të monitorimit është klasifikuar në 3 kategori; po – vendimi është ankimuar; jo- vendimi nuk është ankimuar dhe mundësia e fundit është ‘nuk mora informacion’ për rastet kur afati i regjistrimit të ankimit përfundonte përtej periudhës së caktuar për monitorim (30 qershor 2018). Këto të dhëna janë pasqyruar për secilën gjykatë të shkallës së parë në formën e të dhënave me përqindje mbi numrin total të çështjeve të monitoruara.









Tabela e mëposhtme i paraqet këto të dhëna si numër çështjesh për secilën gjykatë:

Gjykata e Shkallës së Parë	Ankimuar	Pa ankimuar	Pa informacion
Durrës	5	22	5
Gjirokastrë	5	18	9
Korçë	16	10	6
Shkodër	7	12	13
Tiranë	17	12	3
Vlorë	18	12	2
TOTAL	68	86	38

Në lidhje me shkallën e apelit vihen re dy qëndrime kryesore të palëve ndërgjyqëse; e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit shfrytëzohet nga pala humbëse në shkallë të parë. Prirja tjetër është pamundësia e apelit për raste të parashikuara shprehimisht në ligjin e posaçëm për gjykimet administrative dhe rastet kur çështjet e monitoruara kanë qenë kërkesa për lëshim urdhri ekzekutimi¹⁵ nga gjykatat e shkallës së parë.

Një pjesë e veçantë e raportit të monitorimit i përket Gjykatës Administrative të Apelit, ku për shkak të vonesave në përpunimin e ankimeve e për rrjedhojë edhe në zgjidhjen e çështjeve ka një mospërputhshmëri me ritmet dhe eficiencën e gjykatave administrative të shkallës së parë.

¹⁵ Për rastet e monitorimit të gjykatave të shkallës së parë në Gjirokastrë dhe Korçë sqarojmë se nuk ka patur asnjë përzgjedhje të rastësishme sipas metodologjisë së monitorimit dhe monitorim seance gjyqësore për urdhër ekzekutimi. Për rrjedhojë të gjitha çështjet e monitoruara të raportuara si të paapeluara janë të tilla për dy arsye; ose palët nuk kanë zgjedhur të ankohen, ose sipas natyrës së çështjes, bazuar në parashikimet e LGJA vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të apelohej. Rishihni Kapitullin e Parë ku paraqiten tiparet e veçoritë e gjykimet administrativ në Shqipëri.

Kolona në përqindje, në grafikun për secilën gjykatë të shkallës së parë dhe kolona si numër çështjesh në tabelën përmbledhëse për të gjitha gjykatat e shkallës së parë që emërtohen ‘pa informacion’ ju referohet çështjeve gjyqësore të monitoruara dhe të zgjidhura me vendim përfundimtar nga gjykatat e shkallës së parë, por zbardhja e vendimit, dorëzimi i dosjes së çështjes në sekretarinë e gjykatës përkatëse dhe regjistrimi i ankimit brenda një afati ligjor të mirëpërcaktuar ka tejkaluar periudhën e monitorimit. Pra, në këto raste, 38 në total nga 192 çështje të monitoruara, informacioni për apelimin mungon pasi hapat procedural për realizimin e ankimit nga palët kanë vijuar përtej periudhës së monitorimit.

Në lidhje me 68 çështjet në total të ankimuara në Gjykatën Administrative të Apelit, që përbëjnë rreth 1/3 e totalit të çështjeve të monitoruara, është vijuar me marrjen e informacionit në Gjykatën Administrative të Apelit mbi datën e regjistrimit të ankimit, shortin, për caktimin e trupës gjyqësore dhe datën e mundshme të gjykimin nga ana e monitoruesit. Në ndjekje të parashikimeve të afateve ligjore për gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit i është kushtuar vëmendje përlogaritjes së afatit që çështjet e monitoruara në shkallë të parë, të zgjidhura me vendim të formës së prerë nga gjykata përkatëse dhe të ankimuara në Gjykatën Administrative të Apelit janë gjykuar apo jo prej kësaj të fundit brenda 30 ditësh nga regjistrimi i ankimit.

Ndërkohë, për mëse gjysmën e vendimeve përfundimtare të shkallës së parë të ankimuara, më konkretisht për 45 prej tyre, është vërejtur se nga regjistrimi i ankimit në gjykatën e shkallës së parë deri në kalimin e dosjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka kaluar një periudhë kohe prej rreth 2,5 deri 3 muajsh. Kjo ndikon në vonesa për trajtimin dhe adresimin në tërësi të ankimit të çështjeve administrative nga shkalla e parë në atë të apelit. Nga ana tjetër, edhe pse Gjykata Administrative e Apelit ka aktualisht 13 gjyqtarë nga 7 në kohën e krijimit të saj në fund të vitit 2013, përsëri numri i lartë i ankimeve në këtë gjykatë që është instanca e vetme e apelit administrativ në vend, shkakton pamundësi të respektimit të afatit të shkurtër kohor për gjykimin e ankimeve në apel.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga të dhënat e monitorimit rezulton se gjykatat administrative të shkallës së parë e zbatojnë parashikimin e vijimit të gjykimit në mungesë të palëve duke u bazuar mbi aktet e paraqitura në gjykatë. Ajo që vihet re nga përpunimi statistikor i të dhënave të formularëve është se pala institucion shtetëror është ajo që ka përqindjen më të lartë të mosparaqitjes në seanca gjyqësore. Ndërsa gjykata nuk mund t'i detyrojë palët të paraqitur në një gjykim që ndërtohet mbi parimin në gjykimit mbi akte, ndërsa palët kanë mundësinë të zgjedhin të përfaqësohen apo jo, vihet re se zgjedhja nga institucionet shtetërore për të mos marrë pjesë në seanca gjyqësore i ka ndikuar gjykatat administrative që të marrin vendime të ndërmjetme për shtyrje seancash gjyqësore, si dhe raste kur institucionet shtetërore përfaqësohen në gjykim dhe paraqesin arsye për shtyrje të seance kjo kërkesë pranohet nga gjykata. Parashikimi në LGJA është që në seancën përgatitore të paraqiten të gjitha aktet e nevojshme për shqyrtimin gjyqësor të mëtejshëm.¹⁶ Kjo ishte risia që erdhi me LGJA dhe krijimin e gjykatave administrative në dallim nga ekzistenca dhe funksionimi i gjykatave civile.

Meqenëse LGJA parashikon përmbysjen e barrës së provës tek pala e paditur që në shumicën dërrmuese të çështjeve është institucion shtetëror (madje nga monitorimi ka edhe çështje ku të dyja palët janë institucione shtetërore), është pikërisht pala e paditur që duhet të jetë më aktive duke i'u përgjigjur kërkesave të gjykatës administrative dhe të mos vijojë të

përfitojnë nga praktika tolerante që zbaton gjykata administrative, pasi kjo përkthehet në kosto për procesin në tërësi e sidomos është më e ndjeshme për palën ankuese që ka vënë në lëvizje gjykatën.

Nga monitorimi vihet re se pas 5 vitesh funksioni të gjykatës administrative ka ende mungesë njohurish mbi procesin gjyqësor administrativ, sidomos në drejtim të kompetencës lëndore. Në këto raste sugjerimi ynë shkon për avokatët, të cilët duhet të jenë më të përgatitur profesionalisht përse i takon funksionimit të gjykatave administrative, padive dhe afateve që mund të ngrihen në këto gjykata. Shkolla e Avokatisë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të ofrojnë trajnime lidhur me gjyqësorin administrativ në vend, si për avokatët e rinj, ashtu edhe për avokatët ekzistues.

Një gjetje pozitive nga monitorimi është përqindja shumë e ulët e rasteve të shtyrjeve të seancave gjyqësore për shkak të mungesës së trupës gjyqësore. Edhe në ato raste të izoluara që janë hasur gjatë monitorimit kjo ka ardhur si rrjedhojë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në trajnim vazhdues që është një detyrim ligjor për të.

Një gjetje tjetër pozitive nga monitorimi është shmangia e afatit 5-ditor ndërmjet seancës së fundit gjyqësore dhe shpalljes së vendimit, e vërejtur në 1/4 e çështjeve të monitoruara në të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë. Gjykata tërhiqet të marrë vendim dhe e shpall atë brenda të njëjtës datë me seancën e fundit dëgjimore.

Nga monitorimi jashtë seancës gjyqësore, vihet re se ka ende mungesë standardizimi të kalendarit javor të gjyqtarëve. Kjo krijon paqartësi tek publiku dhe formati i njoftimi të seancave duhet të njehsohet të paktën në nivel gjykate, në mos njëtrajtësisht në të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë, duke paraqitur në këtë kalendar përshkrimin e llojit të seancës, sallën e seancës. Pavarësisht se ekziston dhe funksionon edhe portali i gjykatave, përfshirë atë administrative, një mundësi e shtuar kjo në favor të transparencës dhe informacionit për të gjithë të interesuarit, informacioni në portal jo në çdo rast është i përditësuar në kohë reale, pra, shpesh edhe i padobishëm për ata që i drejtohen për informacion portalit mbi seancat, çështjet administrative dhe vendimmarrjet konkrete.

¹⁶ Neni 25, LGJA

Në lidhje me Gjykatën Administrative të Apelit duket se numri i gjyqtarëve nuk i përgjigjet volumit të çështjeve që ankimoren, duke pasur parasysh ato që janë gjykuar në shkallën e parë administrative, pa llogaritur rastet për ankime të akteve normative që kjo gjykatë i shqyrton si juridiksion fillestar, pasi këto raste nuk përbëjnë fokus të monitorimit të zhvilluar. Pavarësisht shtimit të organikës së Gjykatës Administrative të Apelit, nga 7 në 13 gjyqtarë, përsëri kjo trupë gjyqësore e ka të pamundur në realitet të përballojë dhe zgjidhë me vendim ankimet që i paraqiten brenda afatit të përcaktuar në LGJA.¹⁷ Që të bëhen ndryshimet e nevojshme normative për të rritur numrin e gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit apo për të shtuar numrin e Gjykatave Administrative të Apelit nevojitet një studim i ngarkesës së punës së gjykatës së vetme të apelit në këto 5 vite funksionimi të saj. Një mundësi tjetër do të ishte ndryshimi ligjor i periudhës kohore të parashikuar në LGJA për gjykimin dhe vendimmarrjen në apel, pasi parashikimi aktual ka mbetur thjesht i tillë, pa u zbatuar konkretisht nga Gjykata Administrative e Apelit për shkaqet objektive të përmendura. Ndërsa gjykatat në këto raste mund të priren nga synimi për të realizuar një hetim të plotë gjyqësor në mënyrë që të arrijnë një vendimmarrje të drejtë e të paanshme, kjo ndikon në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Në këtë rast duhet gjetur një ekuilibër për të ruajtur ritmin e gjykimin dhe mos cenimin e cilësisë së procesit gjyqësor e për rrjedhojë të vendimit përfundimtar përkatës.

Legjislacioni mbi gjykatat administrative ka pësuar disa ndryshime ndër vite, edhe pse është relativisht një legjislacion i ri (5-vjeçar). Megjithatë, ndryshime të tjera ligjore janë të nevojshme për të shmangur rrezikun e konsolidimit të praktikës që ndiqet duke i përafuar proceset civile me ato administrative (që do të bënte një kthim pas edhe për logjikën e krijimit të një juridiksioni të posaçëm administrativ), si dhe për zgjidhur çështjen e vonesave në gjykimet e apelit. Koha e fituar (shpejtësia e gjykimin) në gjykatat e shkallës së parë humbet në shumëfisha nga radha e pritjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit e më tej në rastet e rekursit dhe për rrjedhojë edhe për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, duke anashkaluar qëllimin e LGJA për një gjykim të shpejtë e efektiv administrativ në vend.

Aktualisht duket problematike dhe jo lehtësisht e parashikueshme se kur do të krijohen organet e vetëqeverisjes së gjyqësorit, duke i'u referuar këtu Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, i cili ka kompetencë ndër të tjera të emërojë gjyqtarët. Ndaj është e vështirë të parashikohet me siguri se kur mund të plotësohet dhe të shtohet organika e gjykatave administrative, gjithnjë nëse do të merret në konsideratë një shtim organike e këtyre gjykatave dhe nëse do të ketë vendimmarrje për këtë qëllim. Në mënyrë që gjyqtarët aktualë të vijojnë të kryejnë detyrën e tyre duhet të kalojnë me suksese procesin e rivlerësimit kalimtar dhe të konfirmohen në detyrë. Ndërkohë, nëse gjatë këtij procesi do të ketë largime nga detyra, atëherë ngarkesa e gjyqtarëve që konfirmohen në detyrë do të rritet, gjë, që do të ketë pasoja direkte në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore administrative, në të gjitha shkallët e gjykimin. Ndaj gjendja aktuale që po përjeton gjyqësori shqiptar nuk ndikon pozitivisht në ecurinë e proceseve gjyqësore administrative për t'iu përgjigjur qëllimeve të krijimit të gjykatave administrative dhe zbatimit të ligjit të posaçëm – LGJA. Për më tepër, është e vështirë të bëhen parashikime të sakta se në çfarë masë dhe për sa kohë procesi i rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mos krijimi i organeve të vetëqeverisjes së gjyqësorit do të ndikojnë në performancën e gjyqësorit administrativ.

¹⁷ Neni 48, LGJA



Qendra Europiane

Rr. "Vaso Pasha", P. 20, Ap. 57, 1001, Tiranë, Shqipëri